



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II nr.1279/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, nga gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen përbarimore të kreditorit D... shpk rr,...me seli në Pejë kundër debitorit Komuna e Pejës e përfaqësuar nga av. Drita Sopi me autorizim, me bazë juridike përbarimore për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë Ep.nr.1270/20 të datës 05.08.2021, jashtë seancës me datë 12.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Komuna e Pejës, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë Ep.nr.1270/20 i datës 05.08.2021, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Pejë me aktvendimin e atakuar, Ep.nr.1270/20 të datës 05.08.2021, e ka refuzuar në tërsi si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Pejës, i parashtruar kundër urdhërit të përbaruesit privat Zija Bala nga Peja P.nr.944/20 dt.04.12.2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori kreditori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, duke shpallur të paligjshme procedurën përbarimore ose aktvendimi të prishet dhe qështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë. Pretendimet e kreditorit se në emër të shërbimeve të kryera debitori ia ka borgj shumën e të hollave të cekura në propozim për përbarim nuk qëndrojnë. Faturat e lëshuara nga kreditorit nuk janë të nënshkruara dhe të pranuar nga Komuna e Pejës, në ato fatura debitori nuk është i treguar sepse e njëjta asnjëherë nuk është pranuar dhe nuk është nënshkruar nga zyrtarët kompetent të debitorit. Kur një dokument i destinuar për një person tjetër nuk është i nënshkruar atëherë nuk dihet se kush është

debitor se kush ka obligim pagesën, në një faturë të panëshkruar, çdo person mund të jetë debitor. Andaj faturat nuk kanë tipare të dokumentit të besueshëm dhe të përshtatshëm. Aktvendimi për përmbartim është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e drejtës materiale përkatësisht LMD-së dhe me parimet e saj.

Përgjigje në ankesë nuk gjendet në shkresat e lëndës.

Gjyqtari individual i Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori D... shpk rr,.....me seli në Pejë, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Komuna e Pejës, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave tatimore për borxh, dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Zija Bala nga Peja, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lejuar përmbartimin me urdhrin P.nr.944/2020 të datës 04.12.2020, ndërsa kundër këtij urdhri, debitori ka ushtruar prapësim përmes të autorizuarës, duke kundërshtuar të gjitha faturat dhe borxhin e pretenduar se urdhëri për lejimin e përmbartimit është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e procedurës kontestimore dhe përmbartimore neni 182 të LPK-së lidhur me nenin 17,71 par.1 nënp 1 dhe 2 të LPP-së dhe LMD. Faturat e lëshuara nuk janë të nënshkruara dhe të pranuar nga Komuna e Pejës, prandaj të njëjtat nuk kanë tipare të dokumentit të besueshëm dhe të përshtatshëm.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 18.12.2020, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe me qëllim të zvarritjes së përmbushjes së detyrimit ndaj kreditorit.

Gjykata Themelore në Pejë pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar Ep.nr.1270/20 të datës 05.08.2021, me të cilin ka vendosur që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, të parashtuar kundër urdhrin të përmbartuesit privat Zija Bala nga Peja P.nr.944/20 dt.04.12.2020.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se prapësimi është i bazuar për faktin se përmbartimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm e paraqitur në origjinal e cila është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht të njëjtat paraqesin bazë për lejimin e përmbartimit në kuptim të dispozitave të nenit 29 të LPP-së. Prandaj duke pasur

parasysh faktin se debitori nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se i njëjti ka paraqitur ndonjë ankesë ndaj kreditorit për faturat e lëshuara nga kreditori, gjykata ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konstatimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të faturave tatimore të periudhës kohore 2018, 2019,2020, Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbarimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbarimore, përkatësisht neni 29 par 1. nën par.1.3 dhe par 3 i cili përcakton se: “ *Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: fatura. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* ”. Gjithashtu neni 37 dhe 40 par.1 pika 3 i LPP-së, përcakton se propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë “*origjinalin apo kopjen e vërtetuar e dokumentit të besueshëm*”, e në rastin konkret faturat po ashtu edhe propozimi i përmban të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e lartpërmendura, andaj si i tillë dokumenti i besueshëm përmban tiparet e nevojshme të përmbarueshmërisë të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Debitori ne prapësim nuk ka ofruar ndonjë argument apo provë me të cilën kishte me paraqitur ndonjë nga shkaqet që janë të parapara me nenin 71 te LPP-së.

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 te LPP “*baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet*”, me çka debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit, por edhe pretendimet e vetë debitorit në prapësim.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij

aktvendimi. Kjo gjykatë pranon konstatimet se faturat janë të nënshkruara nga pala debitore dhe përmbajnë vulën e protokollit nga debitori dhe Drejtoria përkatëse

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështrohet sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës se parë ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka lejuar urdhrin për caktimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, P.nr.944/2020 të dt.04.12.2020.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1279/22 me datë 12.09.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha